



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Rruga Naim Frashëri Nr 37, Tiranë , ALBANIA

## **PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS EDUKIMIT FIGURATIV**

### **1) HYRJE**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Edukimit figurativ është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA, për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së Edukimit figurativ për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve,
- programet përkatëse lëndore,
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi si dhe të lëndës Edukimit figurativ në veçanti,
- përmbajtjen shkencore të lëndës së Edukimit figurativ pas programeve lëndore përkatëse.

### **2) QËLLIMI I PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Edukimit figurativ është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së Edukimit figurativ në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### **3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Edukimit figurativ është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilin fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së Edukimit figurativ që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke patur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe në standardet e mësuesit të lëndës Edukim figurativ. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që

mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

### Fusha : Dokumentet zyrtare

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë të ...	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> <li>• njohë në mënyrë të veçantë:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>ligjin për sistemin arsimor parauniversitar</i></li> <li>- <i>dispozitat normative për arsimin parauniversitar.</i></li> </ul> </li> <li>• shpjegojë dhe të jetë i qartë për të drejtat dhe detyrat e nxënësit.</li> <li>• shpjegojë dhe të jetë i qartë për të drejtat dhe detyrat e mësuesit.</li> <li>• dijë dhe kuptojë funksionin që kanë organet kolegjiale në shkollë.</li> <li>• kuptojë funksionimin e qeverisë së nxënësve në shkollë.</li> <li>• zbatojë drejt udhëzimet e ndryshme të dala nga MASH, duke qenë të përgjegjshëm në zbatimin e kërkesave të dokumentacionit shkollor.               <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>“Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve”</i> si dhe</li> <li>2. <i>“Për zhvillimin e orëve të lira”</i>.</li> <li>3. <i>“Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor”</i>.</li> <li>4. <i>Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore”</i>.</li> </ol> </li> <li>• respektojë të gjitha udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar (DN).</li> <li>• Të drejtat e nxënësve (Neni 21)</li> <li>• Qeveria e nxënësve (Neni 37)</li> <li>• Mësuesi, të drejtat e detyrat (Nenet 43,44,45)</li> <li>• Organet kolegjiale në shkollë (Nenet 51, 53. 54)</li> <li>• Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve".</li> <li>• Udhëzimi Nr.38 , dt.09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë".</li> <li>• Udhëzimi Nr. 35, dt.09.10.2007 i MASH “Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor”</li> <li>• Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH “Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore”</li> <li>• Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi i MASH, Nr. 26 datë 10.08.2010 “Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e Arsimit Parauniversitar në vitin shkollor 2010-1011.</li> <li>• Udhëzimi i Alterteksit 2010-2011</li> <li>• Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz</li> <li>• “Kualifikimi i mësuesve – Teste 2008, 2009 2010”, IKT – Maj 2008</li> </ul>

## Fusha : Programet lëndore

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë të...</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegojë çfarë kupton me standard përmbajtjeje.</li> <li>• shpjegojë çfarë kupton me standard arritjeje.</li> <li>• shpjegojnë ndërtimin e strukturës së programeve të edukimit figurativ në arsimin e detyruar 9 –vjeçar (rubrikat).</li> <li>• shpjegojë ndryshimin midis objektivave të përgjithshëm të lëndës edukim figurativ nga objektivat e përmbajtjes – (për secilën klasë).</li> <li>• dallojë konceptet e artit figurativ që duhet të japë – (për secilën klasë).</li> <li>• dallojë aftësitë që duhet të përftojnë nxënësit përmes programit të lëndës edukim figurativ – (për secilën klasë).</li> <li>• planifikojë mësimin, bazuar mbi një teknikë apo metodë mësimore.</li> <li>• përshkruajë hapat e ndjekura për realizimin e objektivave mësimore.</li> <li>• planifikojë mjetet e nevojshme për realizimin e orës së mësimi, duke dhënë momentet kur i përdor ato.</li> <li>• zbërthejë sipas objektivave me tri nivele një objektivi të dhënë nga programi mësimor.</li> <li>• zbërthejë objektivat e përmbajtjes sipas linjave, duke i përshtatur ato në tema mësimore (plan tematik – modele për një linjë të caktuar të programit).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Standardet e përmbajtjes: edukim figurativ (për arsimin e detyruar) - botim i ISP 2002.</li> <li>• Standardet e arritjes: edukim figurativ (për arsimin e detyruar) - botim i ISP 2004.</li> <li>• Programet lëndore të edukimit figurativ, arsimit 9 – vjeçar.</li> <li>• Buletini – Edukimi artistik - “Kurrikula dhe shkolla” botime të ISP nga vitit 2004, si:  “Si ta kuptojmë dhe ta zbatojmë programin e edukatës figurative”- Kurrikula dhe shkolla, edukimi artistik, fq. 39, botim i ISP 4/2003.  Etj .</li> </ul>

## Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë të...</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• zotërojë një larmi metodash/strategjish të mësimdhënies efikase në lëndën edukim figurativ.</li> <li>• planifikojë mësimin, bazuar mbi një teknikë apo metodë mësimore.</li> <li>• organizojë mësimin bazuar në objektiva për çdo linjë mësimore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mësuarit me objektiva “Modeli A- 94”, Hartimi i objektivave sipas Taksonomisë së Blumit.</li> <li>• Strategjitë e të mësuarit, kapitujt 4,5,6, nga</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• klasifikojë objektivat sipas Taksonominë së Blumit.</li> <li>• hartojë objektivat e orës së mësimimit sipas linjave të programit, duke u mbështetur në Taksonominë e Blumit.</li> <li>• hartojë objektiva të orës së mësimimit për linjat e T, HK, AIV, LJM duke u mbështetur në Taksonominë afektive.</li> <li>• përfshijë në objektivat mësimore çështje të tilla si: genderi, të drejtat e fëmijëve etj.</li> <li>• hartojë një plan ditar sipas një skeme të caktuar, duke dhënë shpjegimet përkatëse hap pas hapi.</li> <li>• shpjegojë metodën e bisedës, së kërkimit, punës në grupe gjatë orëve të veçanta (T apo HK).</li> <li>• shpjegojë metodën me në qendër nxënësin.</li> <li>• kuptojë si punohet me teknika të tilla të Menduarit Kritik si: brainstorming, klaster, Diagrama e Venit etj., gjatë orëve të ndryshme të artit figurativ etj.</li> <li>• planifikojë mësimin, bazuar mbi një teknikë apo metodë mësimore.</li> <li>• planifikojë mjetet e nevojshme për realizimin e orës së mësimimit, duke dhënë momentet kur i përdor ato.</li> <li>• bëjë vlerësimin e arritjeve të nxënësve, duke zbatuar teknika të ndryshme të vlerësimit.</li> </ul>	<p>fq 77-191 dhe kapitulli 9 fq. 271-297, Tiranë 1995.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodatat e mësimdhënies, grup autorësh, Tiranë, 1999, kapitulli 2, 3.</li> <li>• Metoda me në qendër nxënësin – pjesa e parë fq. 4 -37, pjesa 2 moduli 2,4,5, botim i QTKA -2006.</li> <li>• Metodologji e mësimdhënies – Bardhyl Musai – kapitulli 1,2,4 – fq 11-76 dhe 103 - 130.</li> <li>• Udhëzuesi për mësuesit e arteve, pjesa e artit figurativ, botim i IKS 2006.</li> </ul>
---	--

### Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë të...</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstrojë se njeh shumë mirë <i>Elementet dhe parimet e artit figurativ</i>: <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Ngjyra</b> - klasifikimi, vetitë, kontrasti etj.</li> <li>- <b>Vija</b> - llojet dhe cilësia, vetitë.</li> <li>- <b>Sipërfaqja</b> - llojet, ilustrimi i sipërfaqes, mënyrat e të kuptuarit.</li> <li>- <b>Forma dy dimensionale</b> - llojet, roli që kanë, format si simbole.</li> <li>- <b>Forma tre dimensionale</b> - vëllimi dhe dritë hija, vëllimi në pikturë dhe skulpturë, vëllimi dhe burimi i dritës.</li> <li>- <b>Hapësira</b> – llojet, paraqitja, perspektiva.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti “Arti i rilindjes dhe i pavarësisë në Shqipëri”, me autor Ferid Hudhri.</li> <li>• Teksti “ Historia e artit” Gombrich, që përdoret në Akademinë e Arteve.</li> <li>• Manuali Artet, pjesa e artit pamor, botim IKT, 2009.</li> <li>• Tekstet e nxënësit për 9 vjeçarit dhe gjimnazet, Shtëpi Botuese të ndryshme.</li> </ul>

- **Parimet e kompozimit**
- **Baraspesha** – llojet e baraspeshës.
- **Lëvizja** – në pikturë dhe skulpturë.
- **Harmonia**- ritmi motivi, llojet e ritmit.
- **Kontrasti** – llojet e kontrastit.

- shpjegojë qartë:

- a) Mjetet dhe teknikat e vizatimit
- b) Mjetet dhe teknikat e pikturës
- c) Mjetet dhe teknikat e printimit
- d) Fotografia
- e) Proçeset dhe materialet e skulpturës si:  
*modelimi, gdhendja, assemblazhi.*

- shpjegojë saktë vlerat e artit botëror, karakteristikat e veprave dhe përfaqësuesve të tyre.

- Arti egjiptian, grek dhe romak.
- Arti mesjetar.
- Rilindja italiane.
- Impresionizmi.
- Post modernizmi.
- Art i Ri.
- Fovizmi, Ekspresionizmi dhe Kubizmi.

- prezantojë dhe përshkruajë saktë vlerat e artit shqiptar, karakteristikat e veprave dhe përfaqësuesit e tyre.

- Arti mesjetar (shqiptar).
- Arti i pavarësisë në Shqipëri dhe përfaqësuesit.
- Realizmi socialist.